



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

# Monitorimi i prokurimit publik në ndërmarrjet publike (tetor – dhjetor 2023):

---

Dhjetor, 2023

- N.P.L. Kuzhina Qendrore
- K.R.U. Bifurkacioni
- K.R.U. Hidromorava
- K.R.U. Mitrovica







# QEVERISJE E MIRË

## AUTORË:

Egzona Kozhani & Ardit Dragusha



Vizitoni ueb faqen tonë  
[www.dplus.org](http://www.dplus.org)

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,  
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook  
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn  
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter  
[@democracy\\_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube  
[@DemocracyPlus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

## Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V  
Prishtinë, 10000  
Kosovë

+383 (0) 38 749 288  
[info@dplus.org](mailto:info@dplus.org)



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



**Deklarata mohuese:** Ky raport është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti “Qeverisje e mirë: prokurim publik dhe politik-bërje e avancuar” i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+).

# Përmbajtja

Lista e Shkurtesave .....	6
Hyrje .....	7
Metodologjia .....	8
N.P.L. Kuzhina Qendrore - Furnizimi dhe montimi i paneleve solare në Kuzhinën Qendrore – Ritender .....	9
K.R.U. Bifurkacioni – Ndërtimi i objektit të administratës dhe depos së KRU Bifurkacionit .....	11
KRU Hidromorava - Furnizim me kimikate (klor të gazët dhe të lëngët) dhe permanganat kaliumi .....	13
K.R.U. Mitrovica – Sigurimi fizik i dy objekteve të K.R.U. Mitrovica .....	15
Të gjeturat .....	18
Rekomandimet.....	19

# Lista e Shkurtesave

---

**AK** ➤ Autoriteti Kontraktues

---

**ATK** ➤ Administrata Tatimore e Kosovës

---

**DT** ➤ Dosja e Tenderit

---

**GOE** ➤ Grupi i operatorëve ekonomikë

---

**KRU** ➤ Kompania Rajonale e Ujësjesit

---

**LPP** ➤ Ligji për Prokurimin Publik

---

**NP** ➤ Ndërmarrje Publike

---

**NPL** ➤ Ndërmarrje Publike Lokale

---

**OE** ➤ Operatori Ekonomik

---

# Hyrje

Demokrasi Plus (D+) ka vazhduar monitorimin e prokurimit publik në ndërmarrjet publike lokale dhe rajonale. Ndërmarrjet publike, sikurse organizatat tjera buxhetore, operojnë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) për të kontraktuar operatorë ekonomikë për punë, shërbime e furnizime, andaj edhe analizimi i tenderëve është bërë bazuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore që dalin nga ky ligj.

Ky është raporti i katërt i monitorimit të prokurimit publik në ndërmarrjet publike, që përfshinë periudhën e raportimit tetor-dhjetor 2023. Në raport janë të përfshira katër ndërmarrje: N.P.L. Kuzhina Qendrore, K.R.U. Bifurkacioni, K.R.U. Hidromorava, dhe K.R.U. Mitrovica. Monitorimi i aktiviteteve të këtyre ndërmarrjeve është i rëndësishëm, duke u nisur nga roli që këto ndërmarrje kanë në ofrimin e shërbimeve publike për qytetarë. Kryesisht, fushat që këto ndërmarrje mbulojnë janë furnizimi me ujë të pijshëm dhe furnizimi me vakte ushqimore për fëmijë, biznese e qytetarë.

Ky raport përfshinë katër tenderë, si: 1) furnizimi dhe montimi i paneleve solare në Kuzhinën Qendrore; 2) ndërtimi i objektit të administratës dhe depos së KRU Bifurkacionit; 3) furnizimi me kimikate (klor të gazët dhe të lëngët) dhe permanganat kaliumi; dhe 4) sigurimi fizik i dy objekteve të K.R.U. Mitrovica.

# Metodologjia

Hulumtimi i këtij raporti ka nisur nga përzgjedhja e aktiviteteve të prokurimit përmes platformës elektronike e-prokurimit. Përzgjedhja është bazuar në disa indikatorë , si: vlera e parashikuar për tender, lënda që prokurohet, përsëritja e aktivitetit dhe procedura me të cilën zhvillohet aktiviteti i prokurimit.

Pas kësaj, D+ ka dërguar kërkesat për qasje në dokumente publike në ato autoritete kontraktuese që janë përzgjedhur për të qenë pjesë e raportit. Kërkesat për këto dokumente janë bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike.

Këto dokumente janë analizuar kundrejt rregullave të prokurimit publik përcaktuar me legjislacionin në këtë fushë.



# N.P.L. Kuzhina Qendrore - Furnizimi dhe montimi i paneleve solare në Kuzhinën Qendrore – Ritender

Kuzhina Qendrore ka zhvilluar aktivitetin e dytë të prokurimit i cili ka të bëjë me furnizimin dhe montimin me panele solare. Aktiviteti i parë është anuluar për shkak të problemeve në vlerësim të ofertave dhe apelimit të procedurës në OShP. Pak ditë pas anulimit, u publikua njoftimi për kontratën e re me të njëjtën lëndë të prokurimit. Në aktivitetin e dytë ofertuan tre operatorë ekonomikë të cilin kishin ofertuar edhe në aktivitetin e parë, por me çmime shumë të ulëta. Po ashtu, vlera e parashikuar mbeti e njëjtë, përkatësisht 36,000.00 euro.

■ TABELA 1. Operatorët ekonomikë ofertues dhe vlera e ofertave

Nr.	Operatorët ekonomikë ofertues	Vlera e ofertave
1.	Jaha Solar P.N.	22,472.04 €
2.	RA-TA Sh.P.K.	24,345.90 €
3.	N.T.Sh. Elen	26,984.22 €
4.	Unisolar L.L.C.	28,999.10 €

Ofertën më të lirë për këtë aktivitet e kishte dorëzuar operatori ekonomik Jaha Solar P.N., mirëpo ky operator është diskualifikuar sepse katalogu nuk përmbante specifikimet e kërkuara nga autoritetet kontraktuese për solarët.

Operatori fitues i aktivitetit të dytë, N.T.Sh. Elen, për të njëjtën lëndë kishte ofertuar në tenderin e parë me çmim prej 35,478.65 euro apo gati 9,000.00 euro më shtrejtë për produktet me të njëjtat specifika. Në aktivitetin e parë, operatori N.T.Sh. Elen ishte diskualifikuar sepse nuk kishte plotësuar kërkesat teknike lidhur me inverterin (pozicioni 2.1). Në njoftimin për vendim të autoritetit kontraktues, ky i fundit i kishte njoftuar se modeli që operatori ka dorëzuar nuk përmbushë specifikimin teknik, mirëpo, në këtë njoftim kishte sugjeruar një model tjetër që i plotëson kriteret dhe për të njëjtin kishte bashkangjitur link.

■ FOTO 1. Njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 17.08.2023 për tenderin me numër të prokurimit KQ-22-14687-1-2-1

Komisioni i ri-vlerësimit gjatë ri-vlerësimit të aktivitetit të prokurimit duke hulumtuar në website zyrtar të SOLAXPOWER ka gjetur se modeli **X3-MEGA-G2** (weblink zyrtar: <https://www.solaxpower.com/wp-content/uploads/2022/12/X3-MEGA-G2.pdf>) nuk përmbush specifikim teknik andaj duke hulumtuar modele të tjera të SOLAXPOWER X3-Mega, komisioni i ri-vlerësimit ka gjetur se modeli **X3-MEGA-TL** (weblink zyrtar: <https://www.solaxpower.com/wp-content/uploads/2020/07/X3-Mega-50-60kW-datasheet.pdf>) përmbush specifikimin teknik sipas paramasës të cilin OE nuk e ka dorëzuar në ofertë.

Për këtë shkak, pra duke ofertuar me modelit të sugjeruar nga autoriteti kontraktues, operatori ekonomik u shpërblye me kontratë në tenderin e dytë të zhvilluar për furnizim me solarë. Me njoftimin në aktivitetin e parë, autoriteti kontraktues e ka favorizuar produktin, rrjedhimisht edhe ofertuesin, duke i treguar se cilin produkt do e pranoj kështu duke bërë edhe shkelje të parimeve në prokurimin publik. Madje, autoriteti kontraktues edhe ka saktësuar modelin me emër X3-50K-TL në njoftimin për vendim. Autoriteti kontraktues në asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit nuk mund të diskriminoj në dëm ose në të mirë të një apo disa operatorëve ekonomikë<sup>1</sup>. Meqenëse operatori ekonomik fitues njeh kompaninë dhe prodhimet e saja, atëherë është e dyshimt pse nuk ka ofertuar me këtë model qysh në fillim, por është dashur që autoriteti kontraktues të sugjeroj e saktësoj modelin në mënyrë që operatori të fitoj tenderin.

Kjo është në kundërshtim me vet qëllimin e dokumentit “Njoftimi për vendimin e AK-së”, sepse përmes këtij dokumenti tregohet vetëm për rezultatet nga vlerësimi i ofertave dhe këshilla e vetme që mund të jepet në këtë dokument është e drejta për ankesë dhe bazën ligjore për këtë veprim. Pra, autoriteti kontraktues nuk mundet të tejkaloj kompetencat e veta dhe t’i tregoj ofertuesit brendin/modelin që duhet të ofertoj. Vlen të ceket se një veprim i tillë është i paprecedent për shkak se nuk është hasur deri tani në monitorimin e prokurimit publik nga D+.

Në këtë rast, vije në pah edhe një mangësi e dosjes së tenderit, sepse autoriteti kontraktues është dashur të kërkoj autorizimin nga prodhuesi, që dëshmon se OE ka dhe mund të dorëzoj solarët e inventarët. Katalogu i dorëzuar nga OE është i qasshëm<sup>2</sup> në internet dhe jo domosdoshmërisht dëshmon se OE i ka këto pajisje.

Po ashtu, në dosjen e tenderit, për stafin e angazhuar nuk është kërkuar që të dëshmohet se punojnë apo se angazhohen nga punëdhënësi në projekt. Pavarësisht kësaj, operatori ekonomik ka sjellë kontratat me stafin që duhet angazhuar në projekt, ku të gjitha kontratat kanë datën e lidhjes së kontratës por jo edhe skadimin e kontratës. Në po të njëjtën ofertë, operatori ekonomik ka bashkangjitur edhe listën e pagave të nxjerrë nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Nëse i referohemi këtij dokumenti, shohim se të vetmit muaj që punëtorët e deklaruar për tu angazhuar në këtë projekt janë paguar, kanë qenë muaji janar dhe shkurt i vitit 2023. Kjo nënkupton se për muajt në vazhdim<sup>3</sup> të njëjtë nuk kanë marrë paga, që e vë në pikëpyetje nëse kanë qenë të angazhuar në kompani. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktues e ka pranuar ofertën pa u siguruar se kërkesa për stafin është plotësuar.

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 7.2.

2 Modeli X3-50K-TL. <https://cdn.enfsolar.com/z/pp/ykl60d538673cc0a/34-SOLAX-X3-MEGA.pdf>

3 Muajt mars dhe prill, sepse lista e pagave është nxjerrë në muajin prill.

# K.R.U. Bifurkacioni – Ndërtimi i objektit të administratës dhe depos së KRU Bifurkacionit

KRU Bifurkacioni ka ndarë 160,000.00 euro për të ndërtuar objektin e ri të administratës dhe depos. Ndërsa, kontrata është lidhur në vlerë prej 151,906.20 euro me OE Pro & Co Group Sh.P.K. Kjo kontratë ka hyrë në fuqi me 23.10.2023 dhe duhet të përfundoj me 30.01.2024, pra rreth tre muaj kohëzgjatje. Ky operator ka qenë i vetmi ofertues në këtë tender.

■ TABELA 2. Operatori ekonomik ofertues dhe vlera e ofertës

Nr.	Operatori ekonomik ofertues	Vlera e ofertës
1.	Pro & Co Group Sh.P.K.	151,906.20€

Kërkesat që janë paraqitur në këtë tender që kushtëzojnë kryerjen e punëve kanë të bëjnë me stafin dhe me pajisjet e punës. Te kërkesa për punëtorët, autoriteti kontraktues ka shkruar vetëm se operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka minimum tetë (8) punëtorë. Por, autoriteti kontraktues për këta punëtorë nuk ka kërkuar kontratat e punës me kompaninë, as dëshmi nga ATK, e as dëshmi të angazhimit të punëtorëve për këtë aktivitet. Një neglizhim i tillë nga ana e autoritetit kontraktues rrezikon procesin e zbatimit të kontratës sepse i lihet hapësirë operatorit ekonomik që vetëm t'i vendosë disa emra në listë, kurse të njëjtit mund të mos jenë fare punëtorë të kompanisë. Pavarësisht se autoriteti kontraktues nuk ka bërë një kërkesë të tillë, operatori ekonomik prap ka dorëzuar kontratat me punëtorët e paraqitur në listë, mirëpo, të gjitha kontratat përfundojnë në dhjetor të vitit 2023. Në anën tjetër, kontrata me KRU Bifurkacionin ka kohëzgjatje deri në fund të muajit janar 2024. Duke u bazuar në planin dinamik, pikërisht në këtë kohë pritet të mbyllet punimet për administratën dhe të fillojnë ato për depon e KRU Bifurkacionit. Prandaj, mungesa e kësaj kërkesë minon të gjithë aktivitetin sepse pa staf të angazhuar rregullisht në këto punime, kontrata nuk mund të zbatohet. Këtë e ka dëshmuar edhe komunikimi që kishim me menaxherit e kontratës, i njëjti ka njoftuar se dinamika e zhvillimit të punimeve është mjaft e ngadalshme dhe nuk dihet kur do të përfundojnë punimet<sup>4</sup>.

Sipas platformës elektronike e-prokurimi, operatori ekonomik fitues ka 17 kontrata aktive, ku në 11 kontrata është kërkuar që të angazhohen punëtorë për kryerjen e punëve. Sipas dosjeve të këtyre tenderëve, i bije që operatori ekonomik ka në terren, duke kryer punë, rreth 263 punëtorë. Ndërsa, sipas dokumente që ka dorëzuar, në listën e stafit janë paraqitur 45 punëtorë, kurse në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK)<sup>5</sup> janë paraqitur 48 punëtorë të angazhuar në kompani. Kjo nënkupton se operatori ekonomik fitues nuk ka arritur të dësh-

<sup>4</sup> Përgjigjja e marrë përmes e-mail me datë 21.12.2023.

<sup>5</sup> Agjencia për Regjistrim të Bizneseve. <https://arbk.rks-gov.net/TableDetails>

mojë se do të angazhoj stafin e kërkuar për këtë projekt, kjo sepse nuk është kërkuar nga autoriteti kontraktues. Prandaj, autoriteti gjatë draftimit të kërkesave duhet të ketë parasysh rëndësinë e tyre dhe të njëjtat të jenë në përputhje me nevojat dhe qëllimin e projektit. Në një situatë të tillë, autoriteti kontraktues do të duhej të kërkonte plotësim të ofertës, të drejtë që i garantohet me LPP. Këtë situatë, autoriteti kontraktues do të duhej ta konsideronte si mungesë në aplikim dhe të kërkonte nga operatori ekonomik të marr informacione apo dokumente shtesë<sup>6</sup>.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që inxhinieri i gjeodezisë të jetë i licencuar. Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik, gjeodeti i angazhuar në këtë tender është F.E., mirëpo i njëjti ka sjellë licencën e kompanisë së licencuar, pra të personit juridik dhe jo fizik. Kjo kompani, sipas licencës të lëshuar me 15.10.2020, përfaqësohet nga F.E. dhe A.Sh., por nuk dëshmon se F.E. është i licencuar. Sipas Udhëzimit për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve<sup>7</sup>, bëhet diferencimi në mes të gjeodetit të licencuar dhe kompanisë së gjeodetëve. Sipas këtij udhëzimi, kushtet për licencimin e kompanive gjeodete janë që të ketë në marrëdhënie pune të paktën një gjeodet të licencuar dhe një person fizik që plotëson kushtet e shkollimit<sup>8</sup>, mirëpo për aq kohë sa në licencë kompania përfaqësohet nga dy gjeodetë, nuk dëshmon se cili nga ta është i licencuar. Duke u bazuar në listën e stafit, për F.E. theksohet se pozita në kompani është inxhinier i gjeodezisë, dhe jo gjeodet i licencuar, ndërsa në kolonën tjetër është T.N. i cili mbanë pozitën e gjeodetit të licencuar. Pra, operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë se plotëson këtë kërkesë të autoritetit kontraktues dhe rrjedhimisht është dashur që të kërkojë informata sqaruese, siç e mundëson udhëzuesi i prokurimit publik<sup>9</sup>. Megjithatë, autoriteti kontraktues ka pasur bazë edhe të refuzoj të gjithë ofertën duke u bazuar në pozicionin e inxhinierit në kompani ku nuk theksohet se është gjeodet i licencuar.

---

6 Komisioni Rregullativ i Republikës së Kosovës. Rregullore 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 38.3.

7 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ (MMPH) nr. 13/2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe të Gjeodetëve, neni 3.

8 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ (MMPH) nr. 13/2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe të Gjeodetëve. Plotësuar/ ndryshuar nga Udhëzimi Administrativ (MMPH) nr.06/2021 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve, neni 4.1.2.

9 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Udhëzuesi nr.001/2023 për Prokurimin Publik, neni 10.1.

# KRU Hidromorava - Furnizim me kimikate (klor të gazët dhe të lëngët) dhe permanganat kaliumi

Kompania Rajonale e Ujësjellësit (K.R.U.) Hidromorava në korrik të vitit 2023 ka publikuar njoftimin për kontratë për furnizim me kimikate (klor të gazët dhe të lëngët) dhe permanganat kaliumi. Vlera e parashikuar për këtë procedurë ishte përcaktuar 93,960.00 euro, kurse në këtë aktivitet kishin ofertuar tre operatorë ekonomikë.

■ TABELA 3. Operatorët ekonomikë që ofertuan dhe vlera e ofertave

Nr.	Operatorët ekonomikë ofertues	Vlera e ofertës
1.	Afrim Sadriu B.I.	77,875.00 €
2.	Seykos Sh.P.K.	79,615.00 €
3.	GOE Infinitt Sh.P.K. & Light House & E-Logistics L.L.C.	82,370.00 €

Oferta më e lirë për këtë tender ishte anuluar sepse operatori ekonomik nuk kishte sjellë vertetimin e ATK në kohën e kërkuar nga autoriteti kontraktues, kështu edhe oferta e tij ishte refuzuar. Ndërsa, autoriteti kontraktues shpërbleu me kontratë operatorin e dytë më të lirë, Seykos Sh.P.K. Vendimi për të shpërblyer me kontratë kompaninë Seykos Sh.P.K., u apelua nga grupi i operatorëve ekonomikë “Infinitt Sh.P.K. & Light House & E-Logistics L.L.C.,” dhe aktiviteti u pezullua deri në marrjen e vendimit nga OShP.

Sipas dosjes së tenderit, autoriteti kontraktues në mes të tjerash kishte kërkuar nga operatori ekonomik që të dëshmojë se ka një vozitës të licencuar për transportimin e mallrave të rrezikshme sipas ADR (Marrëveshje Evropiane për Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme Rrugore). Po ashtu, në dosje të tenderit ishte kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë të dhënat teknike të kërkuara, duke dorëzuar katalogje, manuale apo broshura. Këto dy kërkesa nuk janë plotësuar nga operatori ekonomik fitues, prandaj edhe lënda ishte apeluar. Fakti që këto dy kërkesa nuk janë plotësuar është vërtetuar nga eksperti i caktuar nga OShP, G.N., në lëndën nr. 662/23. Po ashtu, mos plotësimi i këtyre kërkesave është pranuar edhe nga vet autoriteti kontraktues, duke qenë në pajtim me ekspertizën e ekspertit të OShP-së, kështu edhe OShP mori vendim që ankesa të aprovohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Pas rivlerësimit të ofertave, grupi i operatorëve ekonomikë ankues u shpall fitues, ndërsa, me të njëjtën ofertë, operatori ekonomik që fillimisht u shpall fitues, tani u shpall i papërgjegjshëm për mos plotësim të kërkesave të autoritetit kontraktues. Zyrtari i prokurimit, së bashku me zyrtarin kryesor administrativ janë të obliguar të formojnë një komision për vlerësimin e ofertave, të cilët përbëhen nga anëtarë me aftësi të nevojshme, njohuri dhe

përvojë relevante me kërkesat e prokurimit<sup>10</sup>, andaj në këtë rast kjo kërkesë ligjore nuk është zbatuar nga autoriteti kontraktues, ku si rezultat i mos vlerësimit të duhur të ofertave, janë krijuar vonesa të panevojshme e pastaj kontrata edhe nuk është nënshkruar.

Komisioni gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, duhet të respektojë parimet themelore të prokurimit publik<sup>11</sup>, ndër të cilat është edhe obligimi që autoriteti kontraktues duhet të trajtoj operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese<sup>12</sup>, po ashtu ofertat duhet të vlerësohen me përpikmëri me kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit. Mirëpo në këtë rast, ofertat nuk janë vlerësuar në bazë të këtyre kriterëve ligjore, e rrjedhimisht edhe komisioni ka dështuar të kryej punën për të cilën është emëruar. Prandaj, autoritetet kontraktuese duhet të kenë parasysh gjithmonë se zgjedhja e komisionit vlerësues duhet të bëhet me kujdes. Kjo sepse përmes këtij komisioni zgjedhet operatori ekonomik i cili do të bëjë zbatimin e kontratës, e që i bije se gjithë procesi tutje varet nga vendimi i komisionit. Fakti se roli i këtij komisioni është shumë i rëndësishëm, e dëshmon edhe mënyra e rregullimit ligjor, ku për rastet më specifike, ligji lejon që autoritetet kontraktuese të angazhojnë ekspertë të jashtëm kur kërkohet njohuri dhe ekspertizë e veçantë<sup>13</sup>.

Ky nuk është rasti i vetëm kur si rezultat i mungesës së profesionalizmit të komisionit të vlerësimit, vije deri te vonesa e dështimi i të gjithë aktivitetit. Autoriteti kontraktues duhet të kenë parasysh se secili anëtar i komisionit duhet të nënshkruaj deklaratën nën betim, përmes së cilës deklaron dhe zotohet se ai/ajo do të kryej detyrën e vlerësimit me përgjegjësi të plotë në pajtim me LPP, andaj edhe në raste të tilla autoriteti kontraktues duhet të vë komisionin para përgjegjësisë. Mungesa e marrjes së veprimeve të tilla nga autoriteti kontraktues, kontribon në përkeqësimin e situatës dhe nxitë komisionet që të mos vlerësojnë ofertat sipas detyrës ngase nuk ndëshkohen.

Shpallja fitues i grupit të operatorëve ekonomik Infinit Sh.P.K. & Light House & E-Logistics L.L.C. nuk ka qenë epilogu i këtij aktiviteti, sepse operatori ekonomik Seykos ka parashtruar ankesë në OShP kundër këtij vendimi. Ankesa është parashtruar me 14.12.2023, ndërsa autoriteti kontraktues vetëm pak ditë më vonë, ka inicuar aktivitet të ri të prokurimit me lëndën e njëjtë, pra furnizim me kimikate (klor të gazët dhe të lëngët) dhe permanganat kaliumi, vetëm se kësaj here aktiviteti është zhvilluar me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë<sup>14</sup>. Me datë 20.12.2023 është publikuar njoftimi për kontratë, ku me të është shpërblyer operatori ekonomik Seykos Sh.P.K., si operatori i vetëm që ka ofertuar në këtë aktivitet. Ndërsa, vlera e kontratës është 29,936.50 euro, me kohëzgjatje dy muaj.

Në këtë rast, autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me LPP-në dhe rregulloren e prokurimit publik sepse ankesa ka efekt pezullues<sup>15</sup>, rrjedhimisht edhe autoriteti kontraktues e ka të ndaluar të veproj deri në marrjen e vendimit nga ana e OShP-së. Po ashtu, për tu përdorur një procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, duhet të ekzistojnë rrethanat e parapara me LPP. Ky rast nuk ka pasur të bëjë me ndonjë arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, nuk ka pasur të bëjë me të drejta të pronës intelektuale apo industriale, e as me ndonjë emergjencë ekstreme që është shkaktuar nga ngjarje që nuk ka mundur të parashikohen me arsye nga autoriteti kontraktues<sup>16</sup>.

Bllokimi i aktivitetit në OShP nuk përbënë rrethanë valide për t'u përdorur kjo procedurë sepse është më se e ditur që nëse ofertat nuk vlerësohen sipas kriterëve, vendimi do të apelohej. Po ashtu, LPP përjashton përdorimin e kësaj procedure për rrethanat ekstreme që krijohen nga veprimet neglizhente, ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues<sup>17</sup>. Prandaj, autoriteti kontraktues nuk ka pasur bazë ligjore për përdorimin e kësaj procedure.

10 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 39.5.

11 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 40.1.

12 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 7.1.

13 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 39.9.

14 Numri i prokurimit për këtë aktivitet është nuk ka-23-14048-1-2-5.

15 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 66.1.

16 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 35.2.1.

17 Po aty.

# K.R.U. Mitrovica – Sigurimi fizik i dy objekteve të K.R.U. Mitrovica

Kompania e Ujësjetës Rajonal Mitrovica në fillim të vitit 2023 publikoi njoftimin për kontratë për sigurimin fizik të dy objekteve (objekti qendror i K.R.U. Mitrovica – Rr. Liqenit – Suhodoll, Mitrovicë, dhe depoja qendrore e K.R.U. Mitrovica – Lagjja Tavnik – Mitrovicë), në vlerë të parashikuar të kontratës 35,000.00 euro. Me këtë aktivitet të prokurimit<sup>18</sup>, kjo ndërmarrje kishte qëllim të kontraktonte sigurim fizik për këto dy objekte 24 orë në ditë edhe 7 ditë në javë për një periudhë një vjeçare.

Fillimisht, pas kërkesave të disa operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktues ndryshoi vlerën e parashikuar të kontratës, duke e rritur atë për 11,500.00 euro, pra në vlerë totale 46,500.00 euro. Po ashtu, autoriteti kontraktues hodhi poshtë kërkesat në lidhje me tabelën e përshkrimit të çmimeve, në të cilën operatorët ekonomikë kërkonin që të kishte kategori të veçanta si: orët e natës, orët e ditës, orët e punës gjatë festave zyrtare, orët e punëve gjatë ditëve të fundjavës dhe pushimit, në mënyrë që të plotësohej analiza financiare e kërkuar me dosjen e tenderit. Përveç shtimit të këtyre kategorive, operatorët ekonomikë kërkuar që të krijohet një shabllon i analizës financiare, në mënyrë që të kishin më të lehtë plotësimin e saj, duke evituar mundësinë që plotësimi gabimisht i saj të rezultonte me eliminim.

■ TABELA 4. Përshkrimi i çmimeve

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia e orëve	Çmimi njësi pa TVSh	Çmimi total me TVSh
1.	Sigurimi fizik i objektit të Administratës së KUR"Mitrovica"Sh.A	orë pune	8760		
2.	Sigurimi fizik i objektit të Depos së KUR"Mitrovica"Sh.A	orë pune	8760		

Ndryshimi i vlerës së parashikuar të kontratës u bë përmes formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, i cili u publikua nëntë ditë para mbylljes së afatit për dorëzimin e ofertave. Në këtë formular nuk u shty edhe afati për dorëzimin e ofertave, ndonëse kjo kërkohet me Rregulloren e Prokurimit Publik. Sipas rregullores, në rastet kur jepen informata shtesë apo sqaruese më pak se 10 ditë nga afati i fundit për dorëzimin e ofertave, shtyhet afati për tu dhënë mundësi operatorëve ekonomikë të paktën 10 ditë kohë për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave.

18 Numri i aktivitetit të prokurimit: KURM-23-250-2-2-1

Në këtë aktivitet të prokurimit morën pjesë gjashtë operatorë ekonomikë, dhe autoriteti kontraktues shpërbleu me kontratë grupin e operatorëve ekonomikë Jaguar Security Sh.P.K.; Skyfterat – LIVE Sh.P.K., si oferta me e lirë në vlerë totale 40,296.00 euro.

**TABELA 5. Ofertat e operatorëve ekonomikë dhe vlera e ofertave**

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e kontratës
1.	Kompania e sigurimit fizik Scorpion	44,500.80 euro
2.	GEO Jaguar Security Sh.P.K.; Skyfterat LIVE Sh.P.K.	40,296.00 euro
3.	MEB L.L.C	39,972.80 euro
4.	M-GR Secyurity Sh.P.K.	45,552.00 euro
5.	Security Code	45,552.00 euro
6.	Internat Security Association Sh.P.K.	42,275.18 euro

Në lidhje me vendimin e autoritetit kontraktues për shpërblim me kontratë të GEO Jaguar Security Sh.P.K.; Skyfterat – LIVE Sh.P.K., u ngritën dy kërkesa për ri-shqyrtim, nga MEB L.L.C dhe M-Gr Security Sh.P.K., të cilat u hodhën poshtë nga autoriteti kontraktues si të pabazuara. Pretendimet ankimore të dy operatorëve ekonomikë ishin se:

Grupi i operatorëve ekonomikë i rekomanduar për kontratë nuk i kishte plotësuar kushtet sipas dosjes së tenderit, duke ofertuar në kundërshtim me Ankesin 1, sepse ishte kërkuar të jenë minimum tetë punëtorë me nga 176 orë pune sipas Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Pagës Minimale<sup>19</sup>, ku paga minimale e përcaktuar nga AK ishte në vlerë 250.00 euro neto. Orari zyrtar nga 08:00 deri 16:00 dhe sigurimi fizik duhej të bëhej 24 orë për shtatë ditë të javës, në ndërrime ku duhej paguar shtesat për punë të natës, fundjava dhe festa zyrtare, duke respektuar Ligjin e Punës<sup>20</sup> i cili përfshinë pushimet vjetore, pushimet mjekësore, punën gjatë natës, punën jashtë orarit si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë<sup>21</sup>.

MEB L.L.C ishte eliminuar padrejtësisht për mungesën e Analizës Financiare, të cilin ky operator ekonomik pretendoi se e kishte dorëzuar së bashku me përshkrimin e çmimeve.

Duke mos hartuar shabllonin e analizës financiare, ku mund të ishte përcaktuar saktë numri i orëve të punës (orët e rregullta, orët e natës, orët e fundjavës, orët e festave), KRU Mitrovica shkeli LPP-në i cili përcakton se autoritetet kontraktuese duhet të përpilojnë dosje të tenderit që ofrojnë informata përkatëse lidhur me kontratë, duke përf-

<sup>19</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzim Administrativ (MPMS) nr. 09/2017 për Caktimin e Pagës Minimale në Republikën e Kosovës.

<sup>20</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 03/L-212 i Punës.

<sup>21</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë.



shirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, kërkesat e aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kushtet materiale të saj.

Pas ankimit të vendimit në OShP, kjo kontratë mbeti e bllokur për tre muaj. Paneli Shqyrtues i OShP u detyrua të angazhojë dy ekspertë shqyrtues, por ekspertiza e parë u hodh poshtë pasi eksperti shqyrtues nuk bëri vlerësimin real të gjendjes për shkak të llogaritjeve jo të duhura për nxjerrjen e analizës financiare). Edhe eksperti i dytë profesional shqyrtues i cili kishte detyrë që ta përpiloj një analizë financiare konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe si rezultat i saj të vije deri te një përfundim i saktë dhe i drejtë i pretendimeve ankimore, nuk dha rezultat pasi mungonin indikatorët e matshëm bazuar në kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit.

Vendimi i autoritetit kontraktues që në dosjen e tenderit, konkretisht te përshkrimi i çmimeve në tabelën 4, figuronin vetëm dy kolona për çmimin e orëve të punës dhe pastaj procedimi i këtij tenderi në këtë formë, ndonëse iu ishte bërë e ditur nga operatorët ekonomikë se kërkohej një shabllon i detajuar i analizës financiare, paraqet një neglizhencë të madhe të njësisë së kërkesës dhe zyrës së prokurimit të KRU Mitrovica, gjë që pastaj çoi në dështimin e tenderit.

Përveç dëmit kryesor, që është anulimi i tenderit (sepse OShP nxori vendim për anulim në pamundësi që të vendos në lidhje me pretendimet ankimore), K.R.U. Mitrovica shkaktoi shpenzime të panevojshme te operatorët ekonomikë, të cilët shpenzuan kohë dhe mjete financiare në përgatitjen e dokumentacionit për ofertim, sigurim të ofertave dhe paraqitje e ankesës në OShP.

# Të gjeturat

- N.P.L. Kuzhina Qendrore ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të cilit, në tenderin e njëjtë paraprak të anuluar, i kishte sugjeruar se cili model i përmbushë specifikat e kërkuara nga autoriteti kontraktues.
- K.R.U. Bifurkacioni ka rrezikuar procesin e zbatimit të kontratës duke mos kërkuar kontrata valide të punës apo marrëveshje për angazhim në këtë projekt për punëtorët e kërkuar, ku për shkak të natyrës së kontratës, punëtorët kanë rolin esencial në zbatim të saj.
- K.R.U. Bifurkacioni ka pranuar licencë të personit juridik, në kundërshtim me kërkesat e veta sepse në dosje të tenderit kërkesa ka qenë për licencë të personit fizik (gjeodet i licencuar dhe jo kompani gjeodete e licencuar).
- K.R.U. Hidromorava ka inicuar aktivitet të ri të prokurimit me procedurë të negociuar, për lëndën e njëjtë e cila është apeluar në OShP dhe për të cilën ende nuk është marrë vendim nga OShP.
- KRU Hidromorava ka dështuar të vlerësoj ofertat e operatorëve ekonomikë sipas kërkesave, kështu fillimisht e shpalli fituese ofertën e operatorit ekonomik të cilën në vendimin e dytë e shpalli të papërgjegjshme, për ofertën e njëjtë.
- Për shkak të mungesës së saktësisimit të kërkesave, K.R.U. Mitrovica bëri të pamundur vlerësimin e ofertave dhe çoi në bllokim të aktivitetit të prokurimit deri në anulimi nga OShP-ja.

# Rekomandimet

- Autoritetet kontraktuese (ndërmarrjet publike në këtë rast) duhet të jenë të kujdesshme në hartimin e kërkesave në dosje të tenderit, sepse kërkesat duhet të sigurojnë autoritetin se operatori ekonomik fitues ka kapacitetet e nevojshme për përmbushje të kontratës.
- Autoritetet kontraktuese të ndjekin me përpikmëri kriteret në dosje të tenderit të cilat i kanë vendosur paraprakisht.
- Autoritetet kontraktuese të mos shpërblejnë me kontratë operatorët ekonomikë që nuk kanë përmbushur kërkesat që autoriteti ka vendosur në dosje të tenderit.
- Autoritetet kontraktuese të mos tejkalojnë kompetencat e veta duke dhënë indikacione që në një formë favorizojnë një operatorë ekonomikë.
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) të parasheh në legjislacionin sekondar masa ligjore specifiku për komisionet e vlerësimit të cilët nuk kryejnë obligimin e tyre sipas kërkesës ligjore.
- Autoritetet kontraktuese të përcaktojnë persona të përgjegjshëm dhe profesionistë në komisione të vlerësimit dhe të merren masa ndaj atyre që vepron kundër deklaratës nën betim.
- Autoritetet kontraktuese të mos përdorin procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, nëse për të njëjtën nuk ekzistojnë rrethana e parapara me LPP.



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

